



Duke u mbështetur në nenin 17 shkronjën a), nenin 40 paragrafi 40.2 shkronjën b) dhe c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjin Për Financat Publike dhe Përgjegjësitë nr.05/L-007 i ndryshuar dhe plotësuar Nr.03/L-048 , sipas Qarkores buxhetore 01/2024, nenit 40 paragrafi 2. Pikën 2 të Statutit të Komunës së Klinës, me rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 16.06.2023 si dhe pas debatit të mbajtur me publikun me 27.06.2023, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VI-të të rregullt për vitin 2023, të mbajtur më 30.06.2023 mori këtë:

V E N D I M

Për miratimin

E Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për periudhën 2024-2026 për Komunën e Klinës

1. Miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale për periudhën 2024-2026 si në vijim:

Korniza afatmesme buxhetore 2024-2026	Buxheti aktual 2023	Planifikimi 2024	Vlerësimi 2025	Vlerësimi 2026
Granti i përgjithshëm	5,458,575.00	6,086,118.00	6,539,536.00	6,965,571.00
Granti specifik i arsimit	4,481,266.00	5,453,128.00	5,616,721.49	5,785,223.00
Granti i shëndetësisë	1,577,980.00	1,673,212.00	1,756,872.00	1,844,716.00
Të hyrat vetanake	1,373,774.00	1,436,260.00	1,492,817.00	1,567,546.00
Financimi për shërbimet rezidenciale	160,000.00	150,000.00	200,000.00	200,000.00
Totali :	13,051,595.00	14,798,718.00	15,605,946.49	16,363,056.00

2. Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale , kërkuar me Qarkoren Buxhetore Komunale 2024/01 të lëshuara nga Ministria e Financave, punës dhe transferëve në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

3. Pjesë përbërëse e vendimit është Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026 për Komunën e Klinës.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
5. Me këtë Vendim njoftohen: MAPL, Ministria e Financave, Kryetari Komunës, Drejtoritë komunale, Zyra për Informim dhe Arkivi i Komunës Klinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 101-21732/2023
Klinë më 03.07 2023



Kryesuesi,
Fadil Gashi